

URDHËR
Nr. 170, datë 29.9.2021

**PËR AUTORIZIMIN E FIRMËS SË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
TATIMEVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të pikës 2, të nenit 13, nenit 16 dhe nenit 17, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në kushtet e vakancës së pozicionit të drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve, me qëllim ushtrim normal të veprimtarisë administrative të institucionit,

URDHËROJ:

1. Autorizimin e zotit Klajd Shuka, me detyrë zëvendësdyrektor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të firmosur me cilësinë e autoritetit dhe kompetencave ligjore të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

2. Kompetenca e deleguar për firmosjen e shkresave me cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve do të ushtrohen nga zyrtari i autorizuar sipas këtij urdhri, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri deri në një urdhër të dytë të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

3. Urdhri të publikohet në Fletoren Zyrtare.

4. Ngarkohet z. Klajd Shuka dhe administrata e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj